

**Shoqeria "TRAGJASI POWER" Shpk**

**Adresa: Rruga Mine Peza, Pallati nr. 2, Shkalla nr. 4, Apartamenti nr. 28, Njesia Bashkiake nr. 9  
Tirane.**

## **KONTRATE THEMELIMI**

### **E SHOQERISE "TRAGJASI POWER" Shpk**

Ne Tirane, sot me date 14.12.2022, ne:

1. Valer Hoxha, i biri i Nikos, lindur në Tiranë, Shqiperi, më dt.21.05.1958, banues në Tiranë, me ID nr. F80521067B
2. Kledis Sala, i biri i Fahriut, lindur më dt. 19.02.1998, në Shkodër, Shqiperi, banues në Tiranë me ID nr. J80219049L

Ne baze te vullnetit tone te lire dhe mbeshtetur ne Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe vecanerisht neni 73 pika 2, dhe ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" themelojme shoqerine tregtare "TRAGJASI POWER" Shpk.

#### **Neni 1**

##### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i perbere nga nje shume prej 10 000 leke,  
Ky kapital eshte i ndare , ne 2 kuota.

#### **Neni 2**

##### **Ortakët e shoqerise jane:**

1. Valer Hoxha, i biri i Nikos, lindur në Tiranë, Shqiperi, më dt.21.05.1958, banues në Tiranë, me ID nr. F80521067B, i cili zoteron 1 kuote qe perben 50% te kapitalit ne kapitalin themeltar te shoqerise e barabarte me vleren 5000 leke.
2. Kledis Sala, i biri i Fahriut, lindur më dt. 19.02.1998, në Shkodër, Shqiperi, banues në Tiranë me ID nr. J80219049L i cili zoteron 1 kuote qe perben 50 % te kapitalit ne kapitalin themeltar te shoqerise e barabarte me vleren 5000 leke.

#### **Neni 3**

##### **Objekti veprimtarise**

##### **Shoqeria ka per objekt veprimtarise te saj:**

*Ndërtimin e centraleve Fotovoltaike (Diellore), Hidroteknike etj, te cilat bejne te mundur shfrytezimin e energjise qe gjendet ne natyre dhe qe jane te rinovueshme. Prodhim I energjise elektrike nga burimet e rinovueshme Fotovoltaike (Diellore). Shitja e energjise elektrike klienteve dhe blerja e energjise elektrike nga operatore te ndryshem privat apo shteteror brenda dhe jashte vendit. Transmetimi i energjise elektrike ne sistemin e tensionit te larte, funksion i cili perfshin transmetimin ose interkonjeksionin nderkombetar. Perdorimin e sistemeve te linjave, strukturave mbeshtetese dhe pajisjesh transformuese per transmetimin e energjise elektrike. Shperndarjen, transportin e energjise elektrike ne sistemet shperndarese te tensionit te mesem dhe te ulet, duke patur parasysh shperndarjen*

deri tek konsumatori i fundit. Shërbimet konsulence dhe komisionit financiar të ndërmjetësimit për blerjen, shitjen, prodhimin instalimin e sistemeve të ripërtëritshme të energjisë, formave diellore, turbinave të erës dhe sistemeve hidroelektrike të shfrytëzuara për vete ose për llogari të palëve të treta, marketingun dhe prodhimin e sistemeve elektronike (Software), komponentët e sistemet periferike për burimet e rinovueshme. Tregtim dhe mirëmbajtjen e të gjitha llojeve të makinerive elektromekanike, ajër të kondicionuar, makineri termohidraulike, tregtimin e materialeve të ndërtimit si dhe ndërtimin e marketingun e makinerive të teknologjisë së lartë, elektrike dhe pajisjet elektronike. Kryerja e studimeve për ngrohje, gaz, pajisje hidraulike dhe instalimet elektrike. Ndermjetsim financimi (kredi) me institutet financiare, bankat e nivelit të dytë, të huaja ose vendase për huadhenie për vete ose për palë të treta. Shërbim konsulence në fushën juridike, financiare dhe teknologjike të informacionit dhe komunikimit (TIK). Shoqëria brenda hapsirave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive të tjera, krijimin e sipërmarrjeve të reja dhe pjesëmarrjen në sipërmarrje të tjera, brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera shtesë, me qëllim përmbushjen e veprimtarisë së saj kryesore në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

#### **Neni 4**

##### **Selia e shoqërisë:**

Selia e shoqërisë do të jete në: **Rruga Mine Peza, Pallati nr. 2, Shkalla nr. 4, Apartamenti nr. 28, Njësia Bashkiake nr. 9 Tirane.**

#### **Neni 5**

##### **Menyra e funksionimit të shoqërisë**

Shoqëria do të funksionojë në bazë të statutit të shoqërisë i cili është hartuar e miratuar nga shoqëria, në bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe vecanrisht, dhe ligjin 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit"

#### **Neni 6**

##### **Organet drejtuese të shoqërisë**

Organet drejtuese janë Asambleja e ortakëve dhe Administratori.

Detyrat e Asamblese dhe administratorit janë përcaktuar në statut.

Administrator i shoqërisë është emëruar z. Valer Hoxha me mandat 5 vjet nga regjistrimi në QKB.


#### **Neni 7**

##### **Dispozita të fundit**

Kjo kontratë për themelimin e shoqërisë hartohet në 2 kopje të barabarta dhe nënshkruhet rregullisht nga palët.

#### **ORTAKET THEMELUES**

Valer Hoxha



Kledis Sala

